VENDIM
Nr. 129, datë 6.3.2025

PËR MIRATIMIN E PLATFORMËS ELEKTRONIKE PËR PARAQITJEN E KËRKESAVE EDHE ONLINE TË ZGJEDHËSVE QË VOTOJNË NGA JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 147 dhe 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 25, pika 8, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, në nenin 10 të Kodit të Procedurave Administrative, në nenin 61, pika "ë", të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, në nenin 36, të ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe në vendimin nr. 23, datë 24.1.2024 "Për krijimin e 'E-Mail Server' për postën elektronike zyrtare të sistemit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", dhe vendimit nr. 354, datë 11.7.2024, "Për miratimin e rregullores 'Për përdorimin e postës elektronike zyrtare në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Sistemin Gjyqësor'", me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

VENDOSI:

1. Miratimin e platformës elektronike "Microsoft Exchange Server" për paraqitjen e kërkesave edhe online për zgjedhësit që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
2. Kërkesat e zgjedhësve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, do të dërgohen në adresën zyrtare diaspora@gjykata.gov.al.
3. Gjykata shqyrton dhe vendos për kërkesat e zgjedhësve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, edhe nëpërmjet platformës elektronike "Microsoft Teams", brenda 48 orëve nga data e regjistrimit të kërkesës në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve.
4. Ngarkohet Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETAR
Ilir Rusi